

VENDIM
Nr. 724, datë 3.12.2025

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 14.1.2025, PËR ÇËSHTJEN “IBRAHIMI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN NR. 81057/17 DHE 4 KËRKESA TË TJERA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 14.1.2025, për çështjen “Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 81057/17 dhe 4 kërkesa të tjera, përfundimtar në datën 14.1.2025, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 14.1.2025, “Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 81057/17, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuarve nr. 81057/17 (Ibrahimi), nr. 57542/18 (Selimi), nr. 54121/21 (Dedaj) dhe nr. 7386/22 (Industri Ndërtim (IN) sh.p.k), bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

Numri i kërkesës	Emri i çështjes	Kërkuesit	Dëm jopasuror	Kostot dhe shpenzimet¹
Nr. 81057/17	Ibrahimi kundër Shqipërisë	Besnik Ibrahimi	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro)	
57542/18	Selimi	Denis Selimi Edit Selimi	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) bashkërisht	
54121/21	Dedaj	Tom Dedaj	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro)	
7386/22	Industri Ndërtim (IN) sh.p.k.	Shoqëri e themeluar më 1995 në Dibër		2000 euro (dy mijë euro)

LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

¹ Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.